



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:175208  
Datë: 06.03.2025  
Numri i dokumentit: 06948308

Ac.nr.7117/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Ardian Ajvazi dhe Hunaida Pasuli, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli ne Prishtinë, rruga “L.”, Magjistratja Prishtinë – Fushë Kosovë, pa nr., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson kompania “D.L.R” SH.P.K, me seli në Prishtinë, kundër te paditurit ZH.R nga Lipjani, rruga “B.K”, nr.\*\*, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sabri Kryeziu, avokat nga Lipjani, me objekt të kontestit rimbursimi i dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses dhe ankesën e të paditurit, të paraqitura kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.\*/19, të datës 08.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.02.2025, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, me seli në Prishtinë, rruga “L.”, Magjistratja Prishtinë – Fushë Kosovë, pa nr., si dhe ankesa e të paditurit ZH.R nga Lipjani, rruga “B.K”, nr.\*\*, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.\*/19, i datës 08.12.2021 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.\*/19, të datës 08.12.2021, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit “BKS” me seli në Prishtinë, ashtu që e ka detyruar të paditurin ZH.R nga Lipjani, t’ia paguaj paditëses në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial një të dytën nga shuma e përgjithshme prej 1,478.00 €, gjegjësisht shumën prej 739.00 €, me kamatë ligjore

prej 8 %, duke filluar nga data 08.12.2021, deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet procedurale në emër të taksës gjyqësore në shumë prej 15.00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën II (dy) të dispozitivit e ka detyruar paditësen që të paditurit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 345.4 €, duke u bazuar në përgjegjësinë e ndarë sipas suksesit në procedurë, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësja, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtë materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e paditëses, ta prishë aktgjykimin e ankimuar dhe lëndën me shkresat e saj t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë edhe i padituri, nëpërmes të autorizuarit të tij, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën, aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështja të kthehet në rivendosje, ose aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

*Ankesa e paditëses dhe ankesa e të paditurit, janë të bazuara.*

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja në gjykatën e shkallës së parë, me datë 23.05.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurit për rimbursim të dëmit material dhe jomaterial, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri ZH.R nga Lipjani, që paditëses në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 05.10.2016 në Lipjan, t'ia paguaj shumën prej 1,478.00 €, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, me arsyet sikurse në padinë e paraqitur.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në të cilën sipas propozimit të palëve ka nxjerrë dhe administruar provat shkresore, pas vlerësimit të të cilave ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.\*/19, të datës 08.12.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka vërtetuar faktin se paditësja si rezultat i aksidentit të trafikut të shkaktuar nga i padituri me datë 05.10.2016, në udhëkryqin Lipjan – Magure – Shtime – Prishtinë, ia ka kompensuar dëmin

material dhe jomaterial të dëmtuarit Kamer Shala, në shumë të përgjithshme prej 1,478.00 €, bazuar në dispozitat e Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, për arsye se në bazë të raportit të aksidentit si shkaktar kryesor i aksidentit është paraqitur i padituri, ndërsa automjeti i tij në momentin e shkakimit të këtij aksidenti ka qenë pa mbulesë siguruese, përkatësisht me afat të skaduar të policës së sigurimit. Tutje gjykata ka theksuar se në bazë të ekspertizës së komunikacionit të datës 21.10.2021, e cila është nxjerrë si provë me propozim të autorizuarit të t' paditurit u vërtetua se shkaktar i këtij aksidenti të trafikut janë dy pjesëmarrësit në aksident me lëshimet e tyre, pra përfshirë të dëmtuarin edhe këtu të paditurin. Ku i padituri si ngasës i traktorit "A" të markës IMT nuk e ka respektuar përparësinë e kalimit në hyrje të udhëkryqit në të cilin ishte vendosur shenja STOP, me të cilin rast hynë në udhëkryq duke mos respektuar përparësinë e kalimit ndaj veturës "B", e cila ishte duke lëvizur në rrugë me përparësi kalimi. Duke mos e vlerësuar si duhet shpejtësinë dhe largësinë e mjeteve të cilat lëvizin në rrugë me përparësi kalimi, nuk arrin ta kalojë në tërësi udhëkryqin por duke e penguar lëvizjen e veturës "B", goditet nga vetura "B", e cila i vinte nga ana e majtë duke lëvizur në rrugën kryesore.

Shoferi i veturës "B" ka ngasur veturën me shpejtësi rreth 91 km/h e cila shpejtësi ishte më e madhe se sa ajo e lejuar në atë pjesë të rrugës 40 km/h, me të cilin rast për shkak të shpejtësisë së madhe të lëvizjes nuk ka mundur ta evitojë aksidentin e trafikut me frenim të vrullshëm me rastin e paraqitjes së pengesës në udhëkryq, gjegjësisht traktorit "A", i cili ka qenë duke u kyçur në udhëkryq nga rruga dytësore. Andaj, mbi bazën e lartcekurave gjykata ka vendosur që të aprovoj pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vërtetuar se në rastin konkret ekziston përgjegjësia e ndarë, bazuar në ekspertizën e aksidentit të trafikut, të datës 21.10.2021, të cilës ia fali besimin, ku është konstatuar se shkaktar të këtij aksidenti janë të dy pjesëmarrësit në aksident me lëshimet e tyre të cekura si më lartë.

Për bazën juridike gjykata i është referuar dispozitës së nenit 18 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, lidhur me nenin 176 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Vendimin mbi kamatën e ka bazuar në dispozitën e nenit 277 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, lidhur me nenin 3 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e ka bazuar në dispozitën e nenit 452 paragrafi 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e përkrah Gjykata e Apelit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) dhe neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se janë të qëndrueshme pretendimet ankimore për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, respektivisht aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) të LPK-së dhe neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, sepse dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i përgjithësuar dhe konfuz në vete, e si i tillë del të jetë i paqartë dhe i mangët, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar përkundër faktit se e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, e njëjta nuk ka vendosur

fare për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë, pra nuk është precizuar shuma e cila i është refuzuar paditëses në rastin konkret, e çka kjo e bënë dispozitivin të paqartë, konfuz dhe të pa ekzekutueshëm. Po ashtu edhe pika II (dy) e dispozitivit të aktgjykimit, që i referohet vendosjes për shpenzimet procedurale është e paqartë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, ngase në këtë pikë të dispozitivit gjykata e detyron paditësen që të paditurit t'ia paguajë shpenzimet procedurale, duke u bazuar në përgjegjësinë e ndarë sipas suksesit në procedurë, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit kur i referohet dispozitave ligjore lidhur me shpenzimet procedurale, gjykata thekson *se të autorizuarit të paditësve ia pranoi të drejtën e pagesës së shpenzimeve procedurale*, nga çka rezulton se edhe arsyetimi i aktgjykimit është i paqartë dhe në kundërshtim me dispozitivin dhe me vet shkresat e lëndës. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit është kontradiktor me vetveten dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, ngase ato arsye të cilat janë dhënë janë të mangëta dhe të paqarta, për faktin se në pikën I (një) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë e ka detyruar të paditurin t'ia paguaj paditëses një të dytën nga shuma e përgjithshme e kërkuar me padi, për shkak të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial, kurse në anën tjetër në arsyetimin e aktgjykimit mungojnë arsyet për vlerësimin e gjykatës lidhur me mënyrën se si i ka vërtetuar faktet përkitazi me lartësinë e shumës së aprovuar të kërkesëpadisë së paditëses. Aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë janë të mangëta dhe të paqarta, pasi që nuk është dhënë vlerësimi adekuat në mbështetje të provave relevante. Pra gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla për të arritur deri te përfundimi lidhur me aprovimin e pjesës së kërkesëpadisë së paditëses.

Nën këto rrethana, Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë si shkak i shkeljeve të konstatuara si më lartë nga kjo gjykatë, duhet të priset, pasi që në rastin konkret nuk pati kushte që i njëjti aktgjykim të mund të ndryshohej nga ana e gjykatës ankimore.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë është e detyruar që të veprojë sipas vërejtjeve të gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që me rastin e shqyrtimit të çështjes të ftojë palët në seancë, të vlerësojë të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, t'i administrojë të gjitha provat përkatëse relevante për vërtetimin e fakteve dhe pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave, secilën veç e veç dhe të gjitha së bashku në lidhshmëri me njëra-tjetrën, të vendosë në mënyrë meritore për kërkesëpadinë e paditëses, duke u bazuar në dispozitat e të drejtës materiale dhe në atë mënyrë të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, me një dispozitiv të qartë e rrjedhimisht edhe të ekzekutueshëm, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme secilin fakt të provuar, e i cili në pikëpamje formale dhe materiale duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës, pasi që në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe dhënies shkas krijimit të

Numri i lëndës: 2019:175208  
Datë: 06.03.2025  
Numri i dokumentit: 06948308

shpenzimeve procedurale ashtu që vendimi duhet të jetë i bazuar në dispozita ligjore dhe në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Ac.nr.7117 /2022, me datë 28.02.2025.

Kryetarja e kolegjit,

**Halide Reka, d.v**